



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.** \_\_\_\_\_ **Prot.** \_\_\_\_\_ **Tiranë** \_\_\_\_/\_\_\_\_/2022  
**Nr. Dok.202101099/8**

**Lënda:** *Rekomandim për marrjen e masave për rishikimin e dosjes lidhur me përfitimën e dëmshpërblimit të ish të dënuarit politik të regjimit komunist, A.P*

**MINISTRISË SË DREJTËSISË**  
**Sekretarit të Përgjithshëm**

**Tiranë**

**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Sekretarit të Përgjithshëm**

**Tiranë**

*Të nderuar,*

Në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur dhe trajtuar me vëmendje të veçantë çështjet që prekin shtresën e ish të përndjekurve politikë të regjimit komunist.

Në institucionin tonë është regjistruar kërkesa e avokatit A.P, me anë të së cilës ka prezantuar problematikat lidhur me përfitimin e dëmshpërblimit të ish të dënuarit politik të regjimit komunist, A.P (dosja nr.11302, datë 17.06.2008 e cila është miratuar me VKM nr.714, datë 25.08.2010 me vlerën 0 lekë.)

Zoti P. parashtrohet në kërkesën e tij se ka pasur pasaktësi në formularin e vetëdeklarimit A1 në Ministrinë e Drejtësisë për përfitimet nga ligjet e mëparshme.

Për këtë arsye, është riparaqitur si dokumentacion plotësues, ashtu edhe kërkesë e re drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ku kërkohet bazuar në VKM nr.1253, datë 02.07.2008: *“Ministria e Financave dhe Ekonomisë të verifikojë përputhjen e formularit të vetëdeklarimit me të dhënat e ish-Bankës së Kursimeve (aktualisht Raiffeisen Bank), dhe t’i dërgojë në Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim dërgimin për miratim më pas nga kjo e fundit në KM të vlerës së dëmshpërblimit”*.

Pas interesimit tonë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në shkresën nr.16058/1 prot., datë 07.12.2021, na sqaron se: *“Ministria e Drejtësisë është organi kompetent i përlllogaritjes së dëmshpërblimit financiar përfundimtar për ish të përndjekurit politikë të Republikës së Shqipërisë, ku edhe administrohet praktika e plotë e kësaj përlllogaritjeje në bashkëpunim me institucionet e tjera të përfshira në përputhje me nenin 11 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar. Ministria e Drejtësisë gjatë shqyrtimit të kërkesave bashkërendon punën me Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes, Shërbimin Informativ të Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të Shtetit dhe arkivat e sistemit gjyqësor.”*

Ndërkohë, nga ana jonë është kërkuar informacion edhe në Ministrinë e Drejtësisë e cila me shkresën nr.1480/1 prot., datë 01.04.2022 na ka vënë në dijeni se:

*“Në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, kërkesa për ish të dënuarin është regjistruar në dosjen nr.11302, datë 17.06.2008 dhe dëmshpërblimi financiar është miratuar me VKM-në nr.714, datë 25.08.2010, Lista nr.9, në shumën 0 lekë.*

*Sqarojmë se, në zbatim të nenit 11 dhe 26, të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, Ministria e Drejtësisë, ka përcjellë për verifikim të drejtpërdrejtë për bashkërendim institucioneve të parashikuara nga ligji i mësipërm, me qëllim plotësimin e dosjes me dokumentacionin përkatës dhe marrjen e informacionit të plotë mbi vuajtjen e dënimit, për të vijuar me përlllogaritjen e dëmshpërblimit financiar dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave.*

*Vlen të thuhet se masat e zbritshme të përfituar me ligje të mëparshme sa i përket lekëve në të holla dhe letrave me vlerë, përcaktohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe jo nga Ministria e Drejtësisë.*

*Kështu, nga shkresa me nr.7550 prot., datë 12.07.2010 e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, rezulton se shuma e përfituar është në masën 6.000.000 lekë.*

*Dhe në referim të shkresës së mësipërme të Ministrisë së Financave, parashtrohet që nuk kanë të dhëna për ish të dënuarin A.P, por relatojnë shumën që vetë shtetasi ka deklaruar.*

*Ndërkohë, Ministria e Drejtësisë ka dhënë sqarimet përkatëse për rastin nëpërmjet shkresave të mëparshme, konkretisht shkresës me nr.2987/1 prot., datë 08.04.2019, shkresës me nr.1674/5 prot., datë 25.07.2018, shkresës me nr. A-39/1 prot., datë 28.01.2021, si dhe asaj me nr. A-39/3 prot., datë 21.12.2021 (bashkëlidhur), se nga verifikimi i të dhënave, rezulton se shuma e dëmshpërblimit duhej të ishte 3.226.000 lekë, por nga kjo shumë zbriten përfitimet e marra me ligje të mëparshme.*

*Sa më lart, në kushtet kur kjo shumë prej 6.000.000 lekësh është konfirmuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën e sipërcituar, si institucioni kompetent për përcaktimin e vlerave në të holla dhe letrave me vlerë, Ministria e Drejtësisë nuk e ka kompetencë dhe e ka të pamundur verifikimin e çdo kërkesë për ndryshim të shumave që mund t'i vijë në vijim nga po i njëjti subjekt që kërkon dëmshpërblimin financiar dhe se ka për të përmbushur të gjitha detyrimet e përcaktuara në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar, mbështetur në të dhënat e administruara nga institucionet e ngarkuara në verifikimin e të dhënave për përcjelljen e informacionit."*

*Pavarësisht dispozitave të parashikuara në ligjin nr.7514, datë 30.09.1991, i ndryshuar, "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë", ku fillimisht janë sanksionuar të drejtat e të përndjekurve politikë, rehabilitimi i tyre duhet të kishte përfunduar tashmë, pas tre dekadave. Por për fat të keq, kjo shtresë e shoqërisë shqiptare vijon të mbetet e marginalizuar me problematika thelbësore dhe të pazgjidhura.*

*Nëse do t'i referoheshim pozitës aktuale të kësaj shtrese, vlen të evidentojmë se një pjesë e madhe e të përndjekurve ose kanë humbur jetën gjatë viteve të tranzicionit, pas rënies së diktaturës, ose vuajnë nga probleme shëndetësore, ose nuk kanë marrë informacionin e duhur për afatin dhe dokumentacionin që duhet të paraqesin në përmbushje të kriteve ligjore për përfitimin e dëmshpërblimit financiar.*

Për arsyet e lartpërmendura, mendojmë se janë pikërisht institucionet shtetërore ato të cilat duhet të mirëkuptojnë dhe t'ju vijnë në ndihmë këtyre njerëzve, të cilët kanë lënë pas vuajtje nga më çnjerëzoret të shkaktuara nga një regjim diktatorial, në shkelje të plotë të të drejtave themelore të njeriut në Shqipëri.

Nga ana tjetër, jemi të vetëdijshëm për ngarkesën e institucioneve kompetente shtetërore (Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë) në këtë proces kompleks, por rritja e ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë për kategorinë e të përndjekurve politikë, duhet të vlerësohet si prioritet për rehabilitimin e tyre.

Ministria e Drejtësisë është institucioni i administratës shtetërore përgjegjës për zbatimin e politikës së drejtësisë në kërkim të respektimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjeve, realizimit dhe mbrojtjes së dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, kështu bashkëpunimi me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për mbrojtjen sa më efektive të të drejtave të të përndjekurve politikë, do t'i shërbejë më mirë interesave të kësaj shtrese, për të qenë më efikas në zbatimin e ligjit.

Sa më sipër, sugjerojmë forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve, si dhe koordinim më të mirë, në kuadër të shkëmbimit të dokumenteve dhe informacioneve specifike në lidhje me çështjen e dëmshpërblimit të të përndjekurve, me qëllim rishikimin dhe rivlerësimin e dokumentacionit të depozituar nga përfituesit në raste të caktuara.

Po ashtu, mendojmë se nuk duhet humbur dëshira e mirë institucionale për të zbatuar dispozitat ligjore në mënyrën më objektive dhe efektive të mundshme në favor të qytetarëve.

Për gjithë sa parashtruar, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*:

### **REKOMANDOJMË:**

Marrjen e masave të nevojshme për koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për rishikimin e dosjes lidhur me masën e përfitimit të dëmshpërblimit të ish të dënuarit politik të regjimit komunist, A.P.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar lutemi na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**